www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 252

Tiranë – E premte, 22 janar 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 141/2015 datë 17.12.2015	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar".....	17039
Ligj nr. 142/2015 datë 17.12.2015	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.....	17042

LIGJ
Nr. 141/2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, "PËR TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

5. "Automjet luksoz" konsiderohet autovetura deri në 4+1, e cila plotëson të paktën njërin nga kushtet e mëposhtme:

a) cilindratën të barabartë ose më të madhe se 3000 cm^3; ose

b) vlerën/çmimin të barabartë ose më shumë se 7 000 000 lekë.".

Neni 2

Në nenin 3, pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

"11. Taksë regjistrimi fillestar dhe taksë e përvitshme për automjetet luksoze.".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 4, fjalia e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

"4. Taksa e rentës minerare caktohet sipas shtojcës nr. 2, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.".

2. Paragrafi i tretë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë:

"Referuar shtojcës nr. 2 që i bashkëlidhet këtij ligji, në rastin kur niveli i rentës është si përqindje, shuma e rentës minerare llogaritet duke shumëzuar vlerën e shitjes së produktit (pa TVSH) me përqindjen e rentës, ndërsa në rastin kur niveli i rentës minerare është fiks për njësi, shuma e rentës minerare përcaktohet duke shumëzuar sasitë e shitjes së produktit me nivelin e rentës minerare.".

3. Në pikën 4, fjalia e dytë e paragrafit të katërt ndryshohet si më poshtë:

"Masa e rentës minerare, e përcaktuar në ligjin minerar, ndryshon sipas paragrafëve të parë dhe të dytë, të pikës 4, të nenit 4, të këtij ligji.".

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

"5. Taksa e akteve dhe e pullës caktohet sipas shtojcës nr. 3, e cila i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.".

5. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"9. Taksa mbi primet e shkruara, me përjashtim të primeve të sigurimit për produktet e jetës, shëndetit në udhëtim dhe kartonit jeshil, është 10 për qind e shumës së primit.".

6. Pas pikës 10 shtohet pika 11 me këtë përmbajtje:

"11. Pavarësisht nga pagesa e taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbi makinat luksoze zbatohet taksë regjistrimi në masën 70 000 lekë për regjistrim të çdo makine luksoze dhe taksë e përvitshme në masën 21 000 lekë çdo vit.

Taksa e përvitshme për automjetet luksoze është e vlefshme për 365 ditë. Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoritë Rajonale, në momentin e vjeljes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Pronari i mjetit, i cili nuk kryen pagesën e kësaj takse brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të vlefshmërisë së parashikuar, detyrohet të paguajë një gjobë prej 5 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo muaj vonesë, por jo më shumë se 25 për qind për çdo vit.".

Neni 4

Në nenin 5, pas shkronjës "g" shtohet shkronja "gj" me këtë përmbajtje:

"gj) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.".

Neni 5

Në nenin 8, pas shkronjës "f" shtohet shkronja "g" me këtë përmbajtje:

"g) për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze, zero për qind.".

Neni 6

Në nenin 9, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

"7. Përjashtohen nga pagimi i taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë apo juridikë, të cilët deklarojnë se nuk do të qarkullojnë me mjete në pronësi të tyre gjatë vitit kalendarik, përkohësisht vetëm një herë brenda një viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe që dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit, me kusht që të kenë paguar detyrime të prapambetura, nëse kanë;

c) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës dhe prokurorisë, për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar dhe pagesat e taksës së mjeteve të vërtetuara si të vjedhura nga organet e prokurorisë;

ç) të gjitha detyrimet e prapambetura të taksës së përvitshme dhe të regjistrimit të mjeteve luksoze të sekuestruara apo të konfiskuara me vendim të formës së prerë të gjykatës, të cilat i kalojnë në administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara për qëllime përdorimi apo rishitjeje.".

Neni 7

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2016.

Miratuar në datën 17.12.2015

KRYETARI
Ilir Meta

SHTOJCA NR. 2
RENTA MINERARE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	**Emërtimi i grupit të mineraleve sipas ligjit minerar**	**Renta minerare**
Grupi i parë (I) MINERALET METALIKE		
1	Mineralet e argjendit	10 %
2	Mineralet e arit	10 %
3	Mineralet e bakrit	6%
4	Mineralet e kromit	6%
5	Mineralet e nikelit (nikel-silikat)	6%
6	Mineralet e hekurit (hekur-nikeli)	5%
7	Mineralet e plumbit	5%
8	Mineralet e zinkut	7%
9	Gjithë mineralet e tjera metalike	4%
Grupi i dytë (II) MINERALET JOMETALIKE		
10	Të gjitha mineralet jometalike	4 %
Grupi i tretë (III) QYMYRET DHE BITUMET		
11	Qymyret	19 940 lekë/tonë
12	Bitumet	2 371 lekë/tonë
13	Rërat bituminoze	117 lekë/m^3

14	Reshpet naftore	117 lekë/m³
15	Pirobitumet	2 371 lekë/tonë
16	Qymyr guri	200 lekë/tonë
Grupi i katërt (IV) MINERALET DHE MATERIALET E NDËRTIMIT		
17	Graniti	5 850 lekë/m³
18	Gëlqerorët	47 lekë/m³
19	Gabrot	47 lekë/m³
20	Bazaltet	73 lekë/tonë
21	Konglomerate	7 %
22	Mermeri	4 095 lekë/m³
23	Pllakat e ndërtimit	
23.1	Pllaka guri	228 lekë/m³
23.2	Pllaka ranore	1 456 lekë/m³
23.3	Pllaka graniti	6 825 lekë/m³
23.4	Pllaka mermeri	4 550 lekë/m³
23.5	Pllaka të tjera	6 000 lekë/tonë
24	Pllagjiogranitet	5%
25	Ranoret	491 lekë/m³
26	Serpentinitet	47 lekë/m³
27	Travertinat	2 925 lekë/m³
28	Traktolitet	2 925 lekë/m³
29	Gips	21 lekë /tonë
30	Alabastër	423 lekë/m³
31	Argjila (prodhim çimento, tjegulla, tulla etj.)	15 lekë/tonë
32	Argjila (prodhim diga hidrocentrali)	104 lekë/m³
33	Argjil (për prodhim qeramike)	23 lekë/tonë
34	Rërë lumi	98 lekë/m³
35	Inerte lumore	42 lekë/m³
36	Gjithë mineralet e tjera të grupit të katërt	104 lekë/m³
Grupi i pestë (V) GURËT E ÇMUAR		
37	Gjithë mineralet e grupit të pestë	10%
Grupi i gjashtë (VI) GURËT GJYSMË TË ÇMUAR DHE OPALI		
38	Gjithë mineralet e grupit të gjashtë	10 %
39	**Grupi i shtatë (VII) NAFTA DHE GAZI**	10 %

SHTOJCA NR. 3
TAKSA E AKTEVE DHE E PULLËS

	MASA E TAKSËS
1. Për lëshimin e certifikatave për përdorim brenda vendit	50 lekë
2. Për lëshimin e certifikatave për përdorim nga autoritetet e huaja	200 lekë
3. Për regjistrimin e shtetasve të huaj pas dhënies së shtetësisë shqiptare	2 000 lekë
4. Për procedurën e ndryshimit të emrit/mbiemrit	1 000 lekë
5. Për mbajtjen e akteve të lidhjes së martesës	1 000 lekë
6. Për procedurën për veçim/bashkim familjeje	1 000 lekë

LIGJ
Nr. 142/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006, "PËR SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja "ç", 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në përmbajtje të ligjit hiqen fjalët "komuna" dhe "këshilli i komunës".

Neni 2

Në nenin 3 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:
"7. "Truall" është një sipërfaqe toke, jobujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.".

Neni 3

Në nenin 4, pika 6 riformulohet si më poshtë:
"6. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmjet bashkive dhe organeve tatimore të pushtetit qendror, për çështje që kanë të bëjnë me kompetencën e juridiksionit mbi taksën vendore, bëhet me mirëkuptim. Në të kundërt, palët i drejtohen gjykatës.".

Neni 4

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:
1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
"2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin.".
2. Pika 7 "Taksa për zënien e hapësirave publike", shfuqizohet.

Neni 5

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 11
Shkalla tatimore

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.
2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.".

Neni 6

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:
1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:
"1. Kështet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, kështet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të

biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor."

2. Në pikën 4, fjalia "Tatimpaguesit, me qarkullim nga 0 deri në 2 milionë lekë në vit, paguajnë tatimin fiks, në masën 25 000 lekë në vit, te drejtoritë rajonale tatimore, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, te bankat e nivelit të dytë dhe Postës Shqiptare, për llogari të drejtorisë rajonale tatimore" shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 16 bëhen këto ndryshime:

1. Në fjalinë e parë, fjalët "me qarkullim nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë" zëvendësohet me fjalët "me qarkullim nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë".

2. Në fjalinë e dytë, fjalët "me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë" zëvendësohen me fjalët "me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë".

Neni 8

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.".

2. Në pikën 2, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) taksa mbi truallin.".

Neni 9

Në nenin 21, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën, për taksën mbi tokën bujqësore dhe për taksën mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen, përkatësisht, në anekset 1, 2 dhe 2.1, që i bashkëlidhen dhe janë pjesë përbërëse e këtij ligji.".

Neni 10

Në nenin 22, paragrafi i parë, pas fjalisë së dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa.".

Neni 11

Në nenin 23, pika 1, në fjalinë e parë, pas fjalëve "në pronësi" shtohen fjalët "në përdorim" dhe pas fjalisë së dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.".

Neni 12

Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 23/1

Taksa mbi truallin

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1, të këtij ligji.

3. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.".

Neni 13

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"2. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.

3. Niveli tregues i taksës është sipas aneksit 8 bashkëlidhur këtij ligji.".

b) Pika 4 shfuqizohet.

c) Pika 5 numërtohet "pika 4" dhe ndryshohet si më poshtë:

"4. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.".

Neni 14

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 27
Taksa e ndikimit në infrastrukturë

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind e kësaj vlere, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri 4 për qind e saj.

Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mblidhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.".

Neni 15

Neni 32, "Taksa të tjera", ndryshohet si më poshtë:

"Neni 32

Këshilli bashkiak cakton bazën dhe nivelin e taksës së tabelës.".

Neni 16

Në nenin 35, "Tarifat vendore dhe administrimi i tyre", pika 1, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.”.

Neni 17

1. Anekset nr. 1, 3 dhe 6 zëvendësohen me anekset nr. 1, 3 dhe 6, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Pas aneksit nr. 2 shtohet aneksi nr. 2.1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pas aneksit nr. 6 shtohen anekset nr. 7 dhe 8, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 18

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2016.

Miratuar në datën 17.12.2015

KRYETARI
Ilir Meta

Aneksi 1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS SË NDËRTESËS

	Bashkitë		
	Zona 1	**Zona 2**	**Zona 3**
Kategoritë minimale të ndërtesave	Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë, Kashar, Dajt, Farka. Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë Bashkia Gjirokastër, Njësia Administrative Gjirokastër Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Shkodër Bashkia Kavajë, Njësia Administrative Kavajë Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Lezhë	Bashkia Ura Vajgurore, Njësia Administrative Ura Vajgurore Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative Kuçovë Bashkia Skrapar, Njësia Administrative Skrapar, Bashkia Poliçan, Njësia Administrative Poliçan Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Bulqizë Bashkia Mat, Njësia Administrative Burrel Bashkia Klos, Njësia Administrative Klos Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manzë Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë Bashkia Cërrik, Njësia

			Administrative Cërrik Bashkia Belsh, Njësia Administrative Belsh Bashkia Peqin, Njësia Administrative Peqin Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Gramsh Bashkia Librazhd, Njësia Administrative Librazhd Bashkia Përrenjas, Njësia Administrative Përrenjas Bashkia Patos, Njësia Administrative Patos Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Roskovec Bashkia Divjakë, Njësia Administrative Divjakë Bashkia Mallakastër, Njësia Administrative Ballsh Bashkia Libohovë, Njësia Administrative Libohovë Bashkia Tepelenë, Njësia Administrative Tepelenë Bashkia Memaliaj, Njësia Administrative Memaliaj Bashkia Përmet, Njësia Administrative Përmet Bashkia Këlcyrë, Njësia

			Administrative Këlcyrë Bashkia Dropull, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm Bashkia Maliq, Njësia Administrative Maliq Bashkia Pustec Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë Bashkia Devoll, Njësia Administrative Bilisht Bashkia Kukës, Njësia Administrative Kukës Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë Bashkia Tropojë, Njësia Administrative Bajram Curri Bashkia Mirditë, Njësia Administrative Rrëshen Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Malësi e Madhe, Njësia Administrative Koplik Bashkia Vau i Dejës, Njësia Administrative Vau i Dejës Bashkia Pukë, Njësia Administrative Pukë Bashkia Fushë-Arrëz, Njësia

			Administrative Fushë-Arrëz Bashkia Kamzë, Njësia Administrative Kamzë Bashkia Vorë, Njësia Administrative Vorë Bashkia Rrogozhinë, Njësia Administrative Rrogozhinë Bashkia Selenicë, Njësia Administrative Selenicë Bashkia Himarë, Njësia Administrative Himarë Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Konispol, Njësia Administrative Konispol Bashkia Finiq, Njësia Administrative Finiq Bashkia Delvinë, Njësia Administrative Delvinë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Fushë-Krujë Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras Bashkia Kolonjë,

			Njësia Administrative Ersekë Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Leskovik Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
Lekë/m² në vit			
I. Ndërtesa banimi			
- ndërtuar para 1993	15	10	5
- ndërtuar gjatë dhe pas 1993	30	12	6
II. Ndërtesa të tjera			
- Për tregti dhe shërbime	400	300	200
- Të tjera	100	60	40
Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese	200	150	100
III. Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike.	400	400	400

Shënim I: Në të gjitha njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë.

Shënim II: Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara, si:

- apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa banimi";
- ndërtesë biznesi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime".

Aneksi 2.1

NIVELET TREGUESE TË TAKSËS SË TRUALLIT (JO HAPËSIRË PUBLIKE)

Klasifikimi sipas bashkive	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m2/vit për qëllime biznesi
	I	
Bashkia Tiranë Bashkia Durrës Bashkia Kavajë Bashkia Krujë Bashkia Lezhë Bashkia Lushnjë Bashkia Fier Bashkia Vlorë Bashkia Sarandë	**0,56 lekë/m2**	**20 lekë/m2**
	II	
Bashkia Shkodër Bashkia Elbasan Bashkia Berat Bashkia Korçë Bashkia Delvinë Bashkia Kurbin Bashkia Peqin Bashkia Kuçovë	**0,42 lekë/m2**	**18 lekë/m2**

III		
Bashkia Gjirokastër Bashkia Përmet Bashkia Pogradec Bashkia Librazhd Bashkia Dibër Bashkia Skrapar Bashkia Mallakastër Bashkia Devoll Bashkia Tepelenë	**0,28 lekë/m2**	**15 lekë/m2**
IV		
Bashkia Bulqizë Bashkia Kukës Bashkia Tropojë Bashkia Pukë Bashkia Mirditë Bashkia Malësi e Madhe Bashkia Gramsh Bashkia Ersekë Bashkia Has **Të gjitha bashkitë e tjera**	**0,14 lekë/m2** **0,14 lekë/m2**	**12 lekë/m2** **12 lekë/m2**

ANEKSI 3

NIVELET E TAKSËS SË KALIMIT TË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

	Bashkitë		
	Zona 1	**Zona 2**	**Zona 3**
Kategoritë e ndërtesave	Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë Bashkia Gjirokastër, Njësia Administrative Gjirokastër Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Shkodër Bashkia Kavajë, Njësia Administrative Kavajë Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Lezhë	Bashkia Ura Vajgurore, Njësia Administrative Ura Vajgurore Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative Kuçovë Bashkia Skrapar, Njësia Administrative Skrapar Bashkia Poliçan, Njësia Administrative Poliçan Bashkia Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Bulqizë Bashkia Mat, Njësia Administrative Burrel Bashkia Klos, Njësia Administrative Klos Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manzë Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak Bashkia Krujë, Njësia

			Administrative Krujë Bashkia Cërrik, Njësia Administrative Cërrik Bashkia Belsh, Njësia Administrative Belsh Bashkia Peqin, Njësia Administrative Peqin Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Gramsh Bashkia Librazhd, Njësia Administrative Librazhd Bashkia Përrenjas, Njësia Administrative Përrenjas Bashkia Patos, Njësia Administrative Patos Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Roskovec Bashkia Divjakë, Njësia Administrative Divjakë Bashkia Mallakastër, Njësia Administrative Ballsh Bashkia Libohovë, Njësia Administrative Libohovë Bashkia Tepelenë, Njësia Administrative Tepelenë

			Bashkia Memaliaj, Njësia Administrative Memaliaj Bashkia Përmet, Njësia Administrative Përmet Bashkia Këlcyrë, Njësia Administrative Këlcyrë Bashkia Dropull, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm Bashkia Maliq, Njësia Administrative Maliq Bashkia Pustec Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë Bashkia Devoll, Njësia Administrative Bilisht Bashkia Kukës, Njësia Administrative Kukës Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë Bashkia Tropojë, Njësia Administrative Bajram Curri Bashkia Mirditë, Njësia Administrative Rrëshen Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Malësi e Madhe, Njësia

			Administrative Koplik Bashkia Vau i Dejës, Njësia Administrative Vau i Dejës Bashkia Pukë, Njësia Administrative Pukë Bashkia Fushë-Arrëz, Njësia Administrative Fushë-Arrëz Bashkia Kamzë, Njësia Administrative Kamzë Bashkia Vorë, Njësia Administrative Vorë Bashkia Rrogozhinë, Njësia Administrative Rrogozhinë Bashkia Selenicë, Njësia Administrative Selenicë Bashkia Himarë, Njësia Administrative Himarë Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Konispol, Njësia Administrative Konispol Bashkia Finiq, Njësia Administrative Finiq Bashkia Delvinë, Njësia Administrative Delvinë Bashkia Krujë,

			Njësia Administrative Krujë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Fushë- Krujë Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Leskovik Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
Lekë/m^2			
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	2 000	700	300
III. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200

.

Shënim I: Të gjitha njësitë administrative të tjera zbatojnë nivelin e taksës për zonën 3.

ANEKSI 6

NIVELI TREGUES I TAKSËS SË ZËNIES SË HAPËSIRËS PUBLIKE

Bashkitë		
Zona 1	**Zona 2**	**Zona 3**
Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë Bashkia Gjirokastër, Njësia Administrative Gjirokastër	Të gjitha bashkitë e tjera
Lekë/m2 në muaj		
120	90	60

Shënim: Për njësitë administrative të tjera, niveli tregues i taksës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë.

Aneksi 7

TAKSA E TABELËS

Kategoritë	Niveli i taksës
1) Tabelë për qëllime identifikimi:	
a) Tabelë për qëllime identifikimi, deri në 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	0 lekë/vit
a.1) Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	45 000 lekë/m2
b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit
2) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:	
a) Për Bashkinë e Tiranës	
a.1) Tabelë e thjeshtë	45 000 lekë/m2/vit.
a.2) Tabelë elektronike	90 000 lekë/m2/vit.
b) Për bashkitë qendër qarku	
b.1) Tabelë e thjeshtë	22 500 lekë/m^2/vit
b.2) Tabelë elektronike	45 000 lekë/ m^2/vit
c) Për bashkitë e tjera	
c.1) Tabelë e thjeshtë	13 500 lekë/ m^2/vit
c.2) Tabelë elektronike	27 000 lekë/ m^2/vit.
3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1 000 lekë/m^2/ditë

Aneksi 8

TAKSA E FJETJES NË HOTEL

	Bashkitë		
	Zona 1	**Zona 2**	**Zona 3**
Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Tiranë, Kashar, Dajt, Farka Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës	Bashkia Vlorë, Njësia Administrative Vlorë Bashkia Fier, Njësia Administrative Fier Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Pogradec, Njësia Administrative Pogradec Bashkia Korçë, Njësia Administrative Korçë Bashkia Elbasan, Njësia Administrative Elbasan Bashkia Berat, Njësia Administrative Berat Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Lushnjë Bashkia Gjirokastër, Njësia Administrative Gjirokastër Bashkia Shkodër, Njësia Administrative Shkodër Bashkia Kavajë, Njësia Administrative Kavajë Bashkia Lezhë, Njësia Administrative Lezhë	Bashkia Ura Vajgurore, Njësia Administrative Ura Vajgurore Bashkia Kuçovë, Njësia Administrative Kuçovë Bashkia Skrapar, Njësia Administrative Skrapar, Bashkia Poliçan, Njësia Administrative Poliçan Bashkia Dibër, Njësia Administrative Peshkopi Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Bulqizë Bashkia Mat, Njësia Administrative Burrel Bashkia Klos, Njësia Administrative Klos Bashkia Durrës, Njësia Administrative Sukth Bashkia Durrës, Njësia Administrative Manzë Bashkia Shijak, Njësia Administrative Shijak Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë Bashkia Cërrik, Njësia

			Administrative Cërrik Bashkia Belsh, Njësia Administrative Belsh Bashkia Peqin, Njësia Administrative Peqin Bashkia Gramsh, Njësia Administrative Gramsh Bashkia Librazhd, Njësia Administrative Librazhd Bashkia Përrenjas, Njësia Administrative Përrenjas Bashkia Patos, Njësia Administrative Patos Bashkia Roskovec, Njësia Administrative Roskovec Bashkia Divjakë, Njësia Administrative Divjakë Bashkia Mallakastër, Njësia Administrative Ballsh Bashkia Libohovë, Njësia Administrative Libohovë Bashkia Tepelenë, Njësia Administrative Tepelenë Bashkia Memaliaj, Njësia Administrative Memaliaj Bashkia Përmet, Njësia Administrative Përmet Bashkia Këlcyrë, Njësia

			Administrative Këlcyrë Bashkia Dropull, Njësia Administrative Dropull i Poshtëm Bashkia Maliq, Njësia Administrative Maliq Bashkia Pustec Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Ersekë Bashkia Devoll, Njësia Administrative Bilisht Bashkia Kukës, Njësia Administrative Kukës Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë Bashkia Tropojë, Njësia Administrative Bajram Curri Bashkia Mirditë, Njësia Administrative Rrëshen Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Malësi e Madhe, Njësia Administrative Koplik Bashkia Vau i Dejës, Njësia Administrative Vau i Dejës Bashkia Pukë, Njësia Administrative Pukë Bashkia Fushë-Arrëz, Njësia

			Administrative Fushë-Arrëz Bashkia Kamzë, Njësia Administrative Kamzë Bashkia Vorë, Njësia Administrative Vorë Bashkia Rrogozhinë, Njësia Administrative Rrogozhinë Bashkia Selenicë, Njësia Administrative Selenicë Bashkia Himarë, Njësia Administrative Himarë Bashkia Sarandë, Njësia Administrative Sarandë Bashkia Konispol, Njësia Administrative Konispol Bashkia Finiq, Njësia Administrative Finiq Bashkia Delvinë, Njësia Administrative Delvinë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Krujë Bashkia Krujë, Njësia Administrative Fushë- Krujë Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Laç Bashkia Kurbin, Njësia Administrative Mamurras Bashkia Kolonjë,

			Njësia Administrative Ersekë Bashkia Kolonjë, Njësia Administrative Leskovik Bashkia Has, Njësia Administrative Krumë
Lekë për natë fjetje			
Hotelet 4-5 yje	350	175	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	140	70	35

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 195 lekë